

Shënimi i 10 Majit - Ditës së Shkollës

SHKOLLA FILLORE “RILINDJA” SHËNOI ME KRENARI DITËN E SAJ



Valle popullore luajtur nga nxënësit



Ekspozita me vizatime dhe punime kreative të nxënësve



Pamje e garave mes nxënësve në vrapim



Pamje e garave mes nxënësve në tërheqjen e litarit

10 Maji - Dita e Shkollës “Rilindja” të Sellcës u shënua me krenari dhe në një atmosferë festive. Kjo ditë ishte një moment i veçantë që i bashkonte të gjithë për të kujtuar rrugëtimin e kësaj vatre arsimore, për të nderuar përpjekjet e mësimitdhënësve dhe për të festuar arritjet e nxënësve tanë. Emri “Rilindja” i kësaj shkolle simbolizon shpresën, dijen dhe përkushtimin për një të ardhme më të ndritur.

Që në orët e para të mëngjesit ndihej një atmosferë festive në mjediset e shkollës, ku nxënësit dhe mësuesit uronin njëri-tjetrin dhe përfundonin përgatitjet e fundit për manifestimin e planifikuar. Përgatitjet për këtë ditë të veçantë kishin filluar prej kohësh. Me përkushtim dhe bashkëpunim të ngushtë mes mësimitdhënësve dhe nxënësve, u organizua një program i pasur artistik, kulturor e sportiv që pasqyroi kreativitetin dhe talentin e nxënësve tanë.

Në këtë shfaqje festive u interpretuan valle popullore, këngë dhe vjersha që përcollën emocione tek të gjithë të pranishmit. Gëzimi dhe entuziazmi lexohej në fytyrat e nxënësve, stafit arsimor, si dhe te të pranishmit e tjerë. Po ashtu, gjatë programit u bë edhe shpërblimi i nxënësve që kanë arritur suksese të veçanta në garat e diturisë, në garat artistike dhe në garat sportive.

Një vend të veçantë në këtë festë zuri edhe ekspozita me vizatime dhe punime kreative të nxënësve, e cila pasqyroi përkushtimin dhe aftësitë e tyre në lëmin e artit pamor.

Manifestimi u përmyll me duartroktime të ngrohta, falënderime dhe urime të përzemërta për suksese të mëtejshme.

*Raportin e përgatiti:
Mujdin Sulejmani, arsimtar i gjuhës shqipe
Data: 12.05.2025*